

UNIVERSITETI I GJAKOV S “FEHMI AGANI “
FAKULTETI I FILOLOGJIS -GJAKOV
DEGA:GJUH SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Tema: “E folmja në rrjetet sociale”

Mentori:

Studenti:

Prof.ass.dr.Muharrem Gashi

Haziz Ahmeti

Gjakovë, 2017

Përmbatja

Parathënie.....	4
Hyrje	6
Metodat e studimit.....	6
Metoda përshkruese.....	6
Metoda statistikore	6
Kapitulli I.....	7
I.1. Rruga e standardizimit të gjuhës shqipe.....	9
I.2. Përdorimi i shqipes standarde sot.....	13
Kapitulli II.....	17
II.1 Varieteti i shqipes në rrjete sociale.....	17
II.2. Shembuj.....	17
II.3. Statistika mbi Instagram-in.....	19
Kapitulli III.....	22
III.1. Analiza e materialit.....	22
III.2. Problemet fonetike në shkrim.....	22
III.3. Problemet morfologjike në shkrim.....	25
Kapitulli IV	26
Fjalët dialektore.....	26
IV.1. Zhargonet.....	26
IV.2. Shkrtesat.....	28
IV.3, Tabelat.....	29
Përfundime.....	32
Referencat.....	33

Abstrakt

Duke u nisur nga tema që kam zgjedhur për punim diplome, shihet se sa është e nevojshme dhe urgjente të merret me një nga fushat më të frekuentuara nga rinia, pra me rrjetet sociale dhe me mënyrën e të shprehurit dhe përdorimin e gjuhës.

Kjo temë ka për qëllim të trajtojë mënyrën e të shprehurit të shqipfolësve nëpër rrjetet sociale, si: facebook, twiter, instagram, whatsapp etj.

Gjatë këtij hulumtimi, do të shihet se të rinjtë i përdorin rrjetet sociale gjatë chat-it, dhe mesengjer-it për të komunikuar mes vete. Pastaj mënyrat se sa i përdorin fjalët e huaja, shkurtesat për fjalët shqipe që janë më shumë se gjashtë rrokje, arsyeja pse i përdorin shkurtesat e shumëçka tjetër.

Do vërehet edhe dallimi mes moshave, tek të rinjtë, tek mes-mosha e tek ajo më e vjetra. Kam vërejtur se ndikim tjetër në përdorimin e këtyre varieteteve, është faktori psikologjiko -sociologjik dhe ai psikolinguistik, të cilët, në njëfarë forme, e kaplojnë rrjetin e komunikimit në mes tyre, duke e bërë fare të qartë dallimin në mes grupeve të ndryshme në moshë, në profesion, në lidhje interesash e në çdo lloj fushe ndërveprimi.

Fjalët kyçe: rrjetet sociale, përdorimi i gjuhës standarde, varietetet, facebook, twiter, instagram, whatsapp etj.

Hyrje

Në fshatin tim, të quajtur Kralan, janë afro 250 shtëpi, me një numër goxha të madh të banorëve; gjuha e cila flitet, fatkeqësisht, është larg standardit. Madje, aty ka terma të huaj që e bastardojnë gjuhën.

Si të rinjtë, po ashtu edhe të rriturit, përdorin fjalë që nuk përputhen me standardin, psh: “shka” në vend të “çka”, “hazer” në vend të “gati”, “kallaj” në vend të “lehtë”, “sagllamë” – me siguri etj.

Pastaj kemi përdorimin edhe të disa fjalëve të huaja, kryesisht angleze si: bye, sorry, good, ok, yea, etj. por të pranishme janë edhe përdorimi i disa fjalëve italisht: “grazie”, “qao”, “amigo” etj.

Jo vetëm njerëzit e moshës së re, por edhe fëmijët, përdorin madje shkurtesa si: klm, sps, flm, klb, ntm etj, dhe ato i përdorin në pjesën më të madhe të bisedës.

Ky studim imi ka për qëllim që të tregojë mangësitë, keqpërdorimet e fjalëve, përdorimet e tepruara, dhe rastet e përdorimit pa vend të disa fjalëve.

Tendenca për të provuar që dikujt të ia mësoj gjuhën standarde, ka dalë joprofitabile, për vet faktin se , personat në fjalë ndiheshin të nën muar nëse provoje të ua mësoje standardin. Pesonalisht më kishte ndodhur që planifikova që disa banorëve të ua mësoja ca fjalë që së pari janë shumë më të bukura për vokabularin dhe rrjedhshmërinë në të folur, por interesimi ishte larg atij që do të duhej të ishte.

1. Metodatat e studimit

Ky punim diplome i referohet mënyrës së përshkrimit të asaj se çfarë dhe si shkruhet sot nëpër rrjetet sociale . Po ashtu i referohet edhe statistikave mbi të arriturat e të dhënave mbi temën në fjalë.

1.1. Metoda përshkruese

Me anë të kësaj metode kemi arritur të marrim çdo lloj informacioni mbi konkludimet e përmbledhura shkencore se si po përdoren sot fjalët e gjuhës shqipe dhe mbi dukuritë e reja që po futen pa u kuptuar mirëfilli në gjuhën tonë. Normalisht se këto përdorime të të shkruarit të gjuhës më lehtësuan që të arrij në një përfundim të punimit tim mbi këto trajtesa, dukuri këto nga fusha të ndryshme gjuhësie si sociolinguistikë (e folura e dialekteve, e trevave, qyteteve, fshatrave, familjeve dhe e individëve), në fushën e dialektologjisë, morfologjisë, psikolinguistikës etj. Këto të dhëna kryesisht janë marrë nga literatura e sugjeruar nga mentori im, kryesisht kjo literaturë është shkencore e gjuhësisë, pastaj informacione të tjera të nxjerra nga faqe të shumta në *google* që padyshim lidheshin me temën në fjalë.

2. Metoda statistikore

Me anë të gjendjes statistikore e kam mbajtur gjallë dhe e kam krahasuar gjuhën e përdorur standarde me ato të dialekteve dhe krahinorizmave e të trevave të ndryshme, po ashtu e kam bërë edhe krahasimin e gjuhës së përdorur tek të rinjtë dhe të moshave tjera të përziera. Pastaj krahasimin e temave e përdorimit të gjuhës në mes profesioneve

të njëjta dhe atyre të përziera. Sigurisht se matjet janë bërë në të gjitha rrjetet sociale, por në veçanti në atë të *facebookut* dhe të *instargamit* si më të përdorurat.

Pra, me një fjalë, statistikave më kanë ndihmuar të mas varietete në mes gjuhës standarde dhe asaj dialektore, në përdorimin e fjalëve të huaja kundrejt fjalëve shqipe, në mes të fjalëve të plota kundrejt shkurtesave etj.

Çfarë duhet theksuar se matjet përmes përshkrimeve dhe statistikave janë krejtësisht rastësore dhe individuale . I tërë punimi varet nga komunikimi dhe përdorimi i mjeteve sociale nga të rinjtë dhe moshat tjera. Po ashtu duhet theksuar se punimi është bazuar edhe në varietet e përdorimit të gjuhës standarde, përmes statistikave, jam munduar të shoh se sa i ofrohen standardes së gjuhës të rinjtë e sotëm, sa e respektojnë kodin e drejtshkrimit dhe etikën e mbrojtjes së gjuhës së sotme shqipe.

Çfarë duhet përmendur se është hulumtuar me anë të metodës së përshkrimit dhe asaj statistikore, është edhe e folmja e trevave, e qyteteve të ndryshme shqiptare si ato nga jugu po ashtu edhe nga veriu, sa mund të kuptohen në mes veti dhe se si i gjejnë fjalët e duhura. Kjo edhe shkon përtej të papriturës ku pa asnjë problem merren vesh një gjirokastrit me një prishtinas, edhe se dallimi dialektor dhe ai i largësisë është i madh, ata prapë kuptohen me lehtësi, sepse ua lejon kodi i shkurtesave të fjalëve sidomos të atyre mbi gjashtë rrokje .

Gjatë hulumtimit është parë me interes edhe studimi i fjalëve të ndryshme i të rinjve nga qytetet dhe fshatrat. Përmes komunikimit të tyre gjuhësor pothuajse lehtësisht i kupton se nga cila trevë vijnë, çfarë arritje profesionale kanë, çfarë shkalle intelekti kanë arritur.

Poashtu, nga ky studim vërehet se rrjeti social i përdorur nga moshë e mesme është më i matur dhe më serioz, ndërsa nga të rinjtë është paksa më jo i matur dhe me raste edhe krejtësisht i shturur e me fjalë të ndryshme, ku hasim fjalë e shprehje të huaja, shkurtesa, mos përdorim të shkronjave diakritike, sidomos të shkronjës *ë* që pothuajse fare nuk përdoret.

Një tjetër problem i komunikimit të dobët në gjuhën tonë nëpër rrjetet sociale, është edhe mosfunksionimi jo i mirë i menaxhuesve të rrjeteve dhe mosangazhimi i gjuhëtarëve që të formojnë një lloj rregulli drejtshkrimor, siç e kanë kombet dhe gjuhët e përparuara të botës.

E kam vërejtur se disa nga gjuhët e botës e kanë një gjë të tillë dhe e kanë shpërndarë

nëpër rrjete që pastaj përdoruesit e shkarkojnë lehtësisht pa paguar asgjë, një gjë të tillë e ka arritur edhe gjuhësia jonë, por si duket ende do kohë edhe punë që të jetë në përdorim të mirëfilltë dha pa asnjë problem të komunikojnë përdoruesit e rrjeteve sociale me të.

3. Kapitulli I

3.1 Rruga e standardizimit të gjuhës shqipe

Kuptohet se gjuha është një mjet komunikimi pa të cilën as që mund të imagjinohej bota e sotme dhe në përgjithësi civilizimi i shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Gjuha është një mjet komunikimi pa të cilin nuk mund të mendohet jeta shoqërore.¹ Duke iu referuar këtyre fjalëve, themi se patjetër që edhe në rrjetet sociale gjuha zë vend të mjaftueshëm të përdorimit të saj, edhe pse ka raste kur përdoruesit e rrjeteve sociale përdorin edhe shenja, simbole, foto, animacione dhe shumëçka tjetër, megjithatë gjuha ngelet si mjeti më i domosdoshëm i komunikimit shoqëror.

Gjuha nuk është gjë tjetër vetëm se pjesë e ligjërimit, pjesa reale dhe thelbësore e tij. Ajo është njëherësh prodhim shoqëror i aftësisë ligjëruese dhe bashkësi konventash të domosdoshme, të adaptuara nga trupi shoqëror për të lejuar ushtrimin e kësaj aftësie nga individët.² Secila gjuhë dhe secili komunitet ka doket e zakonet e tij, po ashtu ato zhvillohen dhe e qojnë përpara edhe gjuhën e tyre. Çdo popull komunikon dhe hulumton gjithnjë varietetet e gjuhës së tij, studion dhe shpikë fjalë të reja në gjuhën e tyre .Ato shpeshherë edhe përkufizohen në dialektet e tyre, në të folurën e trevës apo të krahinës se ku jetojnë, megjithatë ajo në tërësi zhvillohet si standarde e folur dhe e shkruar dhe natyrisht pranohet nga të gjithë pa dallim. Standardja është ajo që i mbledhë fjalët nga varetietet e saj dialektore dhe i zhvillon ato më tutje. Secili varietet në bazë të zhvillimit pastaj mund të cilësohet edhe si tërësi e vetme, mu kështu edhe ndahen kombet ose krijohen kombe të reja.

¹ Rugova Sejdiu, 2015 - 34

² Ferdinand De Saussure. Sossyr 1977 - 45.

Edhe gjuha shqipe i ka varietetet e saj dhe normalisht duke u bazuar në to edhe ka ardhur si nevojë e krijimit të një kongresi në Tiranë në vitin 1972 ku u vendos që gjuha shqipe të shkruhej dhe të flitej njëjtë në të gjitha trevat shqipfolëse dhe më gjerë.

Po ashtu duhet të them se fjalori i gjuhës së sotme shqipe, i botuar në Tiranë në vitin 1987, jep këtë përkufizim për gjuhën standarde. Duke shprehur dhe shpjeguar qartësisht fjalët në fjalor, origjinën e tyre, renditjen dhe mënyrën e përdorimit si klasë gramatikore dhe si funksion gramatikor.

Sipas Haugen, një gjuhë tipike standarde duhet të kalojë nëpër këto kritere.

1. Kombi
2. Kodifikimi
3. Kultivimi i funksionit
4. Pranimi.

Çdo gjë që sot mban vulën e gjuhës standarde dhe të njësuar të shkrimit dhe të folmes së shqipes, duhet referuar rilindësve, Shoqërisë së Stambollit, dhe figurave më emblematike rilindëse shqiptare.

Duhet theksuar se idetë e para të formësimit të gjuhës shqipe që gjerë atëherë le që nuk shkruhej njëjtë, por edhe nuk shkruhej me po të njëjtin alfabet.

Një nismë të tillë të standardizimit të shqipes e shohim në mes të shekullit XIX, përkatësisht në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Aty pikasen emrat si Naum Veqilharxhi, Hasan Tahsini, Naim dhe Sami Frashëri, Vaso Pashë Shkodrani, e shumë të tjerë që dhanë kontributin e tyre në fusha të ndryshme të gjuhësisë sonë. Në vitin 1825 Naum Veqilharxhi kishte përpiluar një alfabet origjinal për ta shkruar gjuhën shqipe. Pastaj në vitin 1844 ai e botoi abetaren e tij me alfabetin origjinal që e kishte përpiluar më parë, ndërsa në parathënien e abetares "Evëtari" e ribotuar në vitin 1845, e kishte shpallur programin për shkrimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe.

Pas Veqilharxhit, kontribut të madh dhanë edhe të tjerë, si shembull Naimi krijoi poema e poezi dhe një ndër të shumtat poezi të shkruara ai e shkroi edhe një ku i përshkruan qytetet e trevave të ndryshme të vilajeteve shqiptare të asaj kohe dhe të folmet e tyre që në njëfarë mënyre i lidh bashkërisht si në një gjuhë të njësuar.

d

Po ashtu kontributin e tij të madh në formësimin e gjuhës shqipe e dha edhe

Konstantin Kristoforidhi me përkthimet e tij biblike duke e bërë përkthimin e tyre në të dyja dialektet e shqipes. Po ashtu Konstantin Kristoforidhi veprën e tij e shkroi në të dy dialektet, duke ua mundësuar të gjithëve që ta kuptonin më lehtë shkrimin në varietetin e tyre.³

Po ashtu edhe Faik Konica në botimet e tij në revistën *Albania* dha ide të qarta për gjuhën kombëtare të përbashkët.

Njëra nga ngjarjet më të bujshme rreth unifikimit dhe mënyrës së drejtshkrimit të gjuhës shqipe kishte edhe Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe që u mbajt më 14-22 nëntor të vitit 1908 në qytetin e Manastirit.

Aty u vendos nga delegatët e të gjitha trevave që gjuha shqipe të përdorej dhe të shkruhej me një alfabet, gjë që deri atëherë ajo nuk e kishte këtë status të të shkruarit. Alfabeti i gjuhës mori për bazë ai latin, duke ia shtuar disa shkronja të përbëra dhe dy diakritike. Gjithsej 36 sosh. Pastaj gjuha sikur shkonte në konturat e saj të formësimit dhe unifikimit me hapa të shpejtë e të sigurt, kështu që në vitin 1916-1917 u mbajt në Shkodër Komisia Letrare, e cila vendosi që për bazë e të shkruarit të gjuhës shqipe të merrej e folmja e Elbasanit, trevë e cila shtrihej në mes të dy dialekteve të gjuhës shqipe. Në këtë punim të Komisisë letrare morën pjesë figura të shumta të kulturës dhe dijes së kombit.

Këto vendime të marra nga Komisia Letrare e mbajtur në Shkodër u ratifikuan dhe u futën në përdorim në Kongresin Arsimor të mbajtur në Lushnje në vitin 1920. Këto përpjekje të intelektualëve të kombit sikur vinin duke u zgjeruar e hulumtuar edhe më shumë dhe si rrjedhojë edhe intelektualët që jetonin e vepronin në trevën e Kosovës së pas luftës së LNÇ . Gjegjesisht me krijimin e katedrës së gjuhës shqipe në Prishtinë, që në vitin 1952 me 14-15 nëntor u mbajtën mbledhjet e para e gjerë në formësimin dhe unifikimin e gjuhës shqipe nuk reshtën së punuari.

Vlenë të theksohet se në mbledhjen e parë të mbajtur në Prishtinë në vitin 1952, u vendos që shqiptarët që jetonin në ish-Jugosllavi gjegjesisht në trevat e të ashtuquajturës Krahina autonome e Kosovës dhe e Metohisë, të merrnin për bazë gjuhën dialektore të gegërishtes si gjuhë e shkrimit.

Në mbledhjen e mbajtur më 27-28 prill 1968 u zhvillua organizimi i Konsultës gjuhësore

³ Munishi. 2013, faqe 24.

të

Prishtinës. Kjo konsultë udhëhiqej nga ideja e një kombi e një gjuhe letrare. Në këtë mbledhje u vendos se shqiptarët që jetonin në Jugosllavinë e atëhershme, të përdornin si gjuhë shkrimi po të njëjtën gjuhë që përdorej edhe në Shqipëri.

Nga këto konkludime doli edhe nevoja e mbajtjes së një kongresi të përgjithshëm për unifikimin dhe standardizimin e gjuhës shqipe.

Kongresi u mbajt në Tiranë me 20-25 nëntor të vitit 1972. Në këtë kongres u vendos që si bazë e gjuhës standarde e gjuhës shqipe të merrej e folmja dhe e shkruara e toskërishtes, gjithnjë duke iu referuar shkrimeve të poetit të Rilindje Kombëtare Naim Frashëri.

Përfundimisht në këtë kongres u përmbyll puna e palodhshme me sfida të paimagjinueshme të intelektualëve tanë që bënë shtetin dhe formësuan gjuhën tonë. Tashmë gjuha shqipe kishte një alfabet, një rregull drejtshkrimor dhe një gjuhë të njësuar, e cila pas këtij kongresi do të shkruhej dhe do të flitej njëjtë në të gjitha trevat shqiptare dhe më gjerë.

Ky kongres pra ishte fryt i gjithë atyre dekadave të stërmundimit të intelektualëve tanë të palodhur . Gjuha shqipe si gjithë gjuhët tjera të qytetëruara mori kahen e saj dhe tashmë s'kishte të ndalur.

Tani në këtë vit që po jetojmë, ne ende përballemi me të folmen e dialekteve dhe të nëndialekteve, por mund të themi se për sa i përket gjuhës së shkruar, ajo e ka gjetur veten mjaft mirë dhe po përdoret nga shtresa intelektuale, mediat, dhe institucionet shtetërore e standardizuar dhe pa probleme komunikimi.

Përdorimi shqipes standarde sot

Gjuha e folur dhe ajo e shkruar janë veçuar si dy sisteme të ndryshme shenjash. Gjuha e shkruar ekziston për ta përfaqësuar gjuhën e folur dhe të dyja përzihen aq shumë mes vete sa shpesh ngatërrohet se cila është më e rëndësishme⁴.

Duke qenë se format e shkruara të gjuhës karakterizohen gjithmonë me një stabilitet më të madh dhe me më pak variacion të formës, shqipja standarde në varietetin e shkruar është zotëruar dhe përdorur në përmasa të kënaqshme në Kosovë. Fillimi i përdorimit të rrjeteve sociale bën thyerje në përdorimin e standardit dhe si rezultat gjuha e përdorur në rrjete sociale sot, mund të konsiderohet një regjistër apo varietet i ri.⁵

Termi regjistër është shumë i përhapur në sociolinguistikë dhe u referohet "varieteteve në raport me përdorimin", në kontrast me dialektet, të përkufizuara si varietete në raport me përdoruesin. Pra regjistrat konsiderohen si varietet që lidhen me profesionin dhe që varet nga ajo se kujt i drejtohem dhe si i drejtohem (me shkrim apo me gojë).

Gjuha standarde shqipe ka hyrë tashmë në dekadën e pestë të aplikimit e të funksionimit të saj si gjuhë me prestigj në të gjitha sferat publike. Standardizimi i gjuhës shqipe është arritja e një procesi të gjatë dhe të ndërlikuar historik për vendosjen e rregullave gjuhësore në fushën e fonetikës, morfologjisë, sintaksës e leksikut të gjuhës shqipe, duke bërë kështu njësimin e gjuhës për të gjitha trevat shqiptare. Pas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, u botuan shumë Jjalorë, gramatika, abetare e

⁴ Rugova Bardh, Sejdiu- Rugova Linditë. "Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe", Prishtinë, 2015, faqe 43

⁵ Media, revista kërkimore, Universiteti I Prishtinës, Dega e Gazetarisë, Prishtinë, 2015, faqe 6

libra të tjerë shkollor, në gjuhën e unifikuar shqiptare. Duke qenë se edhe shqipja është e prekur nga diglosia, e që në gjuhësi diglosia është një gjendje në të cilën, në një shoqëri të caktuar ekzistojnë dy gjuhë të lidhura ngushtë, njëra me prestigj të lartë, që përgjithësisht përdoret nga qeveria (institucionet, shkollat, televizionet dhe radiot publike) dhe në tekste formale dhe

Kam marrë shembull një fjalim të politikanit tonë Jakup Krasniqit, i cili në një debat televiziv më datë 05. 02. 2017⁶ shprehet kështu: “Nuk menoj se është naj problem ajo pun

Këtu, përveç mospërdorimit të zanores ë , vërehet dukshëm edhe përdorimi më i madh i të folmeve dialektore në krahasim me standardin e shqipes.

Ca nga fjalët që nuk mund assesi të përdoren në standardin e sotëm

Shembull:

- menoj – mendoj (gegë – toskë)
- noj - (ndonjë) (gegë – toskë)
- pun – punë (mungesa e fonemës ë e fundit (gegë – toskë)
- tan – të gjithëve (gegë – toskë)
- per – për (gegë – toskë)

“menoj se je ne rregull sa i perket asaj pune”

“hajt se sosht noj gjo ajo pun”

“jom lodh sot ne pun”

⁶ www.rubikon.com

Në emisione të ndryshme televizive, vërehet dukshëm niveli më i lartë i përdorimit të të folmeve dialektore, se sa i standardit.

Në emisionin televiziv “Wazzap”⁷ të TV Klan Kosova, vërehen shkelje të tilla, si dhe gabime të shumta sintaksore.

Ja disa shembuj:

pse qysh po menon ti, cili ka me fitue?

cili po ki qef me lu sot status?

e kam than ma heret se ai qi e mlon mesfushen ka me fitu.

topi asht i rumullakt a, op njeri edhe munet me ndodh.

Rastet e mësipërme dëshmojnë për një situatë, ku variacionet dialektore dukshëm mbizotërojnë ndaj normës së shqipes standarde.

⁷ www.Youtube/watch?

4. Kapitulli II

4.1. Varieteti i shqipes në rrjete social

Mënyra e shfrytëzimit të Internetit, e në veçanti të rrjeteve sociale, këto vitet e fundit është rritur ndjeshëm, sidomos nga të rinjtë duke mos përjashtuar edhe të moshës së mesme, pse jo dhe asaj të thyer. Një gjë e tillë edhe në trevat shqiptare vërehet një shfrytëzim jashtë mase i përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale.

Duke qenë se interneti si mjete më i sofistikuar në bartjen sa më të shpejtë të mesazheve, ideve, pikëpamjeve e ndjenjave tona, ka ndikuar, ndër të tjera edhe në përdorimin e gjuhës së shkruar, kjo dukuri e cila e preku edhe gjuhën shqipe. Nga ky përdorim i rrjetit social gjuha po shtrembërohet, nuk po kultivohet, përkundrazi po futen fjalë të huaja, shkurtesa . e fjalë dialektore e jo ato standarde. Arsyetimi kryesor i atyre që e përdorin gjithnjë është elementi kohë. Që informacionet të barten sa më shpejtë që është e mundur përdoren shkurtesa e fjalë të përgjysmuara, ndërsa fjalët e huaja i përdorin më shumë për të ndjerë siç thonë edhe vetë *kullera*. Gjuha dhe format e të folurit nga përdoruesit shqipfolës janë kryesisht jashtë të të folurit apo të shkruarit të shqipes standarde, duke përdorur kryesisht zhargonin, si dhe fjalë dhe shprehje nga gjuhët e huaja.

Për shembull:

*ke kujdes o bir se po bie sipi kali e po vrahesh*⁸

Fjala *bir* në këtë rast nuk është përdorur në kuptimin jo të duhur, thjeshtë fjala “bir” del si fjalë ofenduese që shoku ia thotë shokut.

BIR m. {gjinia mashkullore) Djali i të dy prindërve.

Bir i vetëm. Atë e bir. Im bir. Bir e bijë. Eja, bir i nënës! Bir punëtori (fshatari). Bir në shpirt djalë i adoptuar, bir i qasur. Biri im i dashur. Im bir. I biri i tij ose i saj.

⁸ <https://www.facebook.com/profile.php?id=100005064136063&fref=ts>

Fjala *bir* del si fjalë me kuptim të figurshëm, si një njeri i dashur, i afërt, qoftë si e thënë në mes shokësh qoftë edhe si e thënë në mes prindërve.

Një dukuri mjaft e pranishme në biseda dhe postime të ndryshme në rrjete sociale është edhe zëvendësimi i kodit, i cili është rrjedhim i paevitueshëm i bilinguizmit. Kjo dukuri ndodhë kur një folës flet më shumë se një gjuhë dhe gjatë ligjërimit, duke iu përshtatur rrethanave, zgjedhë një gjuhë që edhe personi tjetër mund ta kuptojë.

Vërehet dukshëm edhe ndikimi i akronimeve ose i shkurtimit të fjalëve p.sh. /7m në vend të *faleminderit*, *sps* në vend të *s'ka përse*, *ntm* në vend të *natën e mirë* etj., pasi që përdoruesit shpesh herë janë nën ndikimin e kohës dhe shpejtësia e të shkruarit luan një rol shumë të rëndësishëm gjatë komunikimit dhe përdorimi i shkurtesave e kursen kohën.⁹ Shqipja si gjuhë standarde është varieteti më pak i përdorur në rrjete sociale. Kjo ndodh si pasojë e faktorëve të ndryshëm si mosha, niveli arsimor, profesioni etj., Por edhe faktorëve të tjerë psikologjik si p.sh. mendimi se përdorimi i standardit nuk është "trandy", ose thënë më mirë nuk është në "modë". Kështu Howard Giles dhe Peter Powesland kanë ardhur në përfundim që pjesëmarrësit e përfshirë në një akt komunikimi janë të prirë ta përshtatin të folurit e tyre me të folurit e bashkëbiseduesit me bindje se kështu do të pranohen, mirëkuptohen dhe pëlqehen më shumë nga bashkëbiseduesit, e që këto pikëpamje i kanë përmbledhur në atë që në sociolinguistikë njihet si teoria e përshtatjes së të folurit¹⁰

Edhe shtrirja gjeografike është një faktorë i rëndësishëm që ndryshon gjuhën apo formën e të folurit.

Rrjetet sociale më të frekuentuara janë Facebook-u dhe Instagram-i. Në këto rrjete çdo ditë, me mijëra përdorues komunikojnë me njëri-tjetrin, duke shprehur mendime, ide e ndjenja, e padyshim këtë komunikim e mundëson gjuha si mjet komunikimi. Facebook-u është një rrjet social i hapur në shkurt të vitit 2004, i zotëruar dhe i drejtuar nga anëtarët permanent mbikëqyrës.¹¹ Poashtu ai konsiderohet si rijeti social me më së shumti përdorues aktivë. Ai ofron shumë shërbime për përdoruesit e tij

⁹ https://www.instagram.com/p/BE1XR2xkDRE/?taken-by=:sarcasm_al:

¹⁰ (Media, revistë kërkimore: 94).

¹¹ Facebook, Inc. (<https://sq.wikipedia.org/wiki/Facebook>)

duke filluar nga hapja e një profili personal, shtimin e miqëve, kërkesat ose postimet si foto e shkrime që përdoruesit duan ti publikojnë. Ai bën edhe shkëmbimin e mesazheve, bashkimin në grupe të individëve me interesa të përbashkëta etj.

Poashtu edhe gjjha shqipe si shumë gjuhë tjera pavarësisht përdorimit jo të drejtë të saj, ajo e gjen veten në këtë një të ashtu si gjuhët tjera.

Përveç Facebook-ut, viteve të fundit, ka marrë hov të madh edhe përdorimi i Instagram-it, si njëri nga rrjetet sociale më të lehta dhe më të shpejta për komunikim. Instagram u krijua nga Kevin Systrom dhe Mike Krieger dhe u lansua në treg në Tetor të vitit 2010.

Përkundër Facebook-ut, Instagram-i si qëllim kryesor ka shpërndarjen e fotove, e kohëve të fundit po ashtu të videove, por ka të hapur edhe opcionin *Insta Direct*, për të komunikuar me njëri-tjetrin.

Risia që ka sjellë Instagrami është vënia në funksion e thurjes(#), si një mundësi që ndihmon përdoruesit të gjejnë më shpejtë dhe më lehtë përdorues tjerë apo edhe gjëra që ju interesojnë si foto,video, ngjarje, vende etj., ku vetëm duke klikuar mbi tekstin me thurje, automatikisht hap në postime të përdoruesve të ndryshëm, të cilët kanë përdorur po atë tekst, për të treguar për po atë ngjarje, ose për diçka tjetër në lidhje me të. Për shembull, nëse përdorim #Shqip, dhe klikojmë mbi të, do të dalin postime të përdoruesve që kanë përdorur po atë fjalë.

Statistika mbi Instagram-in

- Instagram ka rreth 100 milionë shfrytëzues aktivë në muaj.

Rreth 40 milionë foto postohen çdo ditë.

- Ndodhin rreth 8500 pëlqime çdo sekondë.

- 26 nga 100 top brendet kanë më shumë se 10 mijë ndjekës në Instagram.

- 10 nga 100 top brendet kanë më shumë se 100 mijë ndjekës në Instagram.

- 40% të fotove në Instagram janë të filtruara.

Lo-Fi është filtruesi më i përdorur.

- 98% të fotove të postuara në Instagram shpërndahen edhe në Facebook.
- 28% e shfrytëzuesve të Internetit në SHBA me moshë në mes të 18 dhe 29 vjet përdorin Instagramin.
- 14% e shfrytëzuesve të Internetit mes 30 e 49 vjet përdorin Instagramin.
- Vetëm 3% e shfrytëzuesve të Internetit mes 50 e 65 vjet përdorin Instagramin.

Përdoruesit e rrjeteve sociale, sidomos të rinjtë, përdorin varietete të ndryshme të gjuhës, ku më pak i përdoruri nga ta është ai standard.

Duke qenë se shqipja i ka dy dialekte, toskë dhe gegë, dallon edhe gjuha e përdorur në rrjete sociale, në varësi të asaj se cilit dialekt i përkasin përdoruesit. Për me tepër, ajo dallon edhe brenda një dialekti të caktuar.

Për shembull, një përdorues i Facebook-ut nga Shqipëria, i dialektit verior, gjegjësisht i trevës së Shqipërisë së mesme, e përdor këtë formë të gjuhës:

Tije bo tiron e vlla vetem po pate vajt tn ne lu

per ty paska qen jeta gjith dimrin ne elb gjith veren ne divjak

Kshu esht kjo pun dje un e sot ti

Sa i zgjuar je more djal sikur ke mbaruar 20 fakultete¹²

Ndërsa një i tillë nga Kosova, i dialektit gegë më në veri të Shqipërisë, e përdor këtë formë të gjuhës:

ska drejtsi ska pas kurr e sidomos n 'futboll.

Per juve Urime ama ata e kan meritu e kan lu ma mir..

Bonu met fortit o shok ndashe mukon triumfus hahahaha

Ka dal o bir se po rrzohesh pi kali e po vrahesh hahahahahahaha¹³

Mënyra e të folurit që përdoret në rrjetet sociale ndikon edhe në mënyrën e të folurit jashtë tyre, duke futur kështu në fjalorin jashtë kufijve virtual shumë shprehje nga

¹² <https://www.facebook.com/Interist7frefHs>

¹³ (<https://www.facebook.com/profile.php?id=100005064136063&fref=ts>)

gjuhët e huaja, shkurtesa dhe shprehje të tjera të cilat kalojnë në zhargon. P.sh. *"hi"* ose *"hallo "* në vend të *"përshëndetje"*, *"po dukesh nice"* në vend të *"po dukesh bukur"*, *"jam happy"* në vend të *"jam i lumtur"*, *"op "* në vend të *"po "* dhe të ngjashme

5. Kapitulli III

5.1. Analiza e materialit

Duke hulumtuar mbi këto rrjete sociale si dukuri e domosdoshme e jetës dinamike në mbarë rruzullin tokësor, pra edhe tek ne, vërejmë se përdorimi i gjuhës standarde është larg nga përdorimi i drejtë i tij . Si duket përdoruesit e sotëm më shumë e parapëlqejnë atë të folme të trevës se ku jetojnë dhe atë dialektore.

Këto shkelje të mëdha gjuhësore prekin pothuajse çdo degë të gjuhësisë, ndaj në këtë kapitull do t'i paraqesim problemet më të mëdha të hasura më shpesh në rrjete sociale, duke filluar nga problemet fonetike në shkrim, problemet morfologjike në shkrim, fjalët dialektore, fjalët e huazuara, zhargonet, shkurtesat etj.

5.1.1. Problemet fonetike në shkrim

Nga materialet që kemi marrë për t'i analizuar, kemi hasur në shumë probleme nga fusha e fonetikës.

Shkeljet më të mëdha kanë të bëjnë me mospërdorimin e fonemës *ë*, si në pozitë fundore ashtu edhe brenda fjalës, duke e zëvendësuar atë me fonemën *e*, ose duke mos e përdorur fare as si të tillë, si dhe përdorimi i *q-së* dhe *sh-së* në vend të *ç-së*. Për shembull:

...shkaje kabon

*Kolegë ju lutem bisedoni me UP¹⁴
ta dimë se qfar vendimi po merret...*

Në këtë shembull *ç-* ja është zëvendësuar me *q-në* dhe *sh-në*, ndërsa *ë*-ja nuk është përdorur fare, as e zëvendësuar nga *e*-ja, siç ndodhë në shumicën e rasteve, p.sh. a te përshtatet ne 12 e 10.

Kjo dukuri ndodh edhe për vetë faktin se shumica e tastierave nuk i kanë fonemat *ë* dhe *ç* si butona të veçantë, por duhet të shkruhen me anën e kombinimeve të butonave. Tjetër dukuri është edhe asimilimi i togjeve të zanoreve *ua/ue*, *ye* dhe *ie*, në zanoret e parë *u*, *y* dhe *i*. Në disa raste të rralla përdoret edhe togu *ue*. Për shembull: Hmm une kom harru¹⁵

¹⁴ (<https://www.facebook.com/messages/salihi.egzona.7>)

¹⁵ <https://www.facebook.com/messages/100009981700208>

Ndër dukuritë e përdorura janë edhe përdorimi i n intervokalike (ndërzanore) në vend të r, dukuri kjo në vend të rotacizmit, apo e dukuri si apofonia apo kalimi nga a<o dhe ë<o, metateza, elizioni, sinkopa, apokopa etj.

Rotacizmi: i dhem syni – syri - marrë nga një film, më 4 mars 2017.

Apofonia: të duken bukur vorrtezat – marrë nga një postim në facebook.

Kontraksioni: për voe mos um ndrro – nga instagram.

Afereza: urime Lika edhe shumë tjera t'lumtuna – nga facebook.

Sinkopa: kshu është kjo pun dje un e sot ti – nga facebook.

Apokopa ... ata e kan meritu – nga facebook.

Metateza: Ai momenti kur pas mësimit do luash futboll – nga facebook.

Elizioni: oki mfal se nashta t'pengova – nga facebook.

Pra, të gjithë këta shembuj i kam nxjerrë nga facebook, instagram, duke përcjellë mënyrën e të shprehurit të njerëzve në momente të ndryshme.

5.1.2. Problemet morfologjike në shkrim

Përveç problemeve nga fusha e fonetikës, kemi hasur edhe në shumë probleme morfologjike. Ndër problemet më të mëdha është mos respektimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm. Për shembull:

.. .si i ratkocit je dal(<https://www.facebook.com/profile.php?id=100000251231752&fref=nf>: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)^.

Te përdorimi i përemrave kemi hasur në përdorimn e këtyre formave: Përemri vetor:

ne < na

edhe na tdoim(<https://www.instagram.com/p/BFMY01izQIy/?taken-by=dafina.zeqiri>: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017) Përemri vetor:

im/ime < jem/jeme

Jeta

jem

tdu(<https://www.facebook.com/LedriOfficial/photos/a.476240105816012.1073741828.476233802483309/848976308542388/?type=3&theater>: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)?

tim/time < tem/teme

Me [#zemrenteme](https://www.instagram.com/p/w9Cw280kv2/?tagged=zeinrenteme)(<https://www.instagram.com/p/w9Cw280kv2/?tagged=zeinrenteme>: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)

Te materialet e marra në rijete sociale, hasem në këto përdorime të foljes : Pjesorja e shkurtër:

S'du me shki-u(https://www.instagram.com/p/BD-PHIMILpk/?taken-by=ard_islami: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)... Përdorimi i gabuar i mbaresave të pjesores: .. tjerët për të sjellur suksese(. <https://www.facebook.com/LabinofTahiriOfficial/?fref=ts>: shikua r për herë të fundit më 05.07.2017)...

Ku sipas "Gramatika e gjuhës shqipe 1" me prapashtesën *-ur* e formojnë pjesoren :

b) foljet e zgjedhimit II, me përjashtim të nënklasës 3 të klasës II

(shih më sipër b) si dhe të foljeve me temë më -l, -ll, -r, -rr (klasa II/I) që pësojnë ndërrimin -e -/je-: -o- ose -a-: -o- në të kryerën e thjeshtë (shih mëposhtë b)(Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe 1: 2002:300);

Ndërsa me prapashtesën *-ë* e formojnë pjesoren:

b) foljet nënklasës 1 të klasës II të zgjedhimit II, që dalin me temë më -l, -ll, -r, -rr dhe që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin -e -/je~: -o- ose -a~: -o-: vjel-ë, dal-ë, mbjell-ë, sjell- ë, tjerr-ë, marr-ë(Po aty, 2002:300);

Paskajorja e tipit *me punu* në vend të trajtës së standardizuar *për të punuar*.

S'du me shkru per nivelin artistik te fotografit, sa jam

per me tregu qe(https://www.instagram.com/p/BD-PHIMILpk/?taken-by=ard_islami: shikuar për herë të fundit më 06.06.2017)...

Përcjellorja e tipit *tu/tujpunu* në vend të trajtës së standardizuar *duke punuar*.

.. ish tu e bo punimin(<https://www.facebook.com/messages/100009981700208>: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)

5.1.3. Fjalët dialektore

Për shkak të rrethanave të ndryshme të krijuara në Shqipëri dhe në Kosovë pas Kongresit të Drejtshkrimi të vitit 1972 edhe imponimi i standardit nuk u realizua në të njëjtën mënyrë në të dyja vendet. Kështu në Shqipëri ekzistonte ligji për imponimin e standardit dhe përdorimin e saj në të gjitha domenet e përdorimit të saj, ndërsa në Kosovë nuk ekzistonte një ligj për një imponim tillë dhe kështu standardi u përdor shumë më pak, madje edhe në domenet formale të përdorimit të saj.

Përveç fjalëve dialektore, përdorim të madh kanë edhe fjalët krahinore. Fjalët

dialektore e krahinore janë ato fjalë që përdoren vetëm në njërin dialekt ose në një të folme të caktuar, që nuk përdoren në dialektin tjetër a në të folmet e tjera(Thomai,2006:273).

Në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, si në Maqedoni e Mal të Zi, ishte krijuar gjendje edhe më e rëndë për përvetësimin dhe përdorimin e standardit, sepse gjuha shqipe nuk ishte gjuhë e parë zyrtare.

Për këto arsye dhe arsye tjera sociolinguistike e psikolinguistike fjalët dialektore përdoren më shumë në rrjete sociale në krahasim me standardin.

a kije deni problem, a kë

kiie(https://www.instagram.com/p/BGPMcBRuOJd/?taken_bv=xhevdet_jashari: shikuar për herë të fundit më 05.07.2017)?

● Zhargonet

Zhargoni që njihet edhe si gjuhë e fshehtë, gjuhë joformale, e cila përdoret për t'u shprehur më lehtë, e që përdoret përa ta dalluar një grup nga një grup tjetër, në bazë të faktorëve të ndryshëm shoqërorë; është njëra nga format më të përdorura në rrjetet sociale.

"Kadal o bir se po rrzohesh e po vrahesh" - www.facebook.com, 03. 06. 2017.

"Një macu di si të ypesë prej qefit." - www.instagram.com, 03. 07. 2017

"Bravo tamam si skifter" - www.instagram, 03. 07. 2017

● Shkurtesat

Përdorimi i shkurtesave përbën një element shumë të rëndësishëm në komunikim në rrejtet sociale. Gati çdo përdorues në vend të fjalës së plotë, përdor shkurtesa.

Shkurtesat vërehen në fjalët si: flm – faleminderit, sps – s'ka përse, ntm – natën e mirë etj.

Një shfrytëzues në facebook, por edhe në instagram, për t'iu falënderuar miqve për urimet me rastin e ditëlindjes së tij, e ka përdorur këtë formë të gjuhës: "flm pi kejtve për urimet e kaloni mr", përsorim, pra, ky, i gabuar.

Faleminderit	flm.....	Faleminderit	flm	flm shum	Thank you	thnx
(shumë)		+ emri	+ emri	+ emri	(very much)	

Shumë	flm flm	flm xoni	flm shum	flm Eri	Thank you	thnx
Faleminderit	flm	flm doni	Tina	flm Stima	Thank you	Arieta
		flm toni	flm shum		Thank you	
Faleminderit	flm shum	flm Ibo	Nisi		Very much	
faleminderit	flm					
shumë	flm					
faleminderit	flm					
	shum					
faleminderit						
faleminderit						
shumë						

Nga rastet e falënderimit të marra deri në një kohë, kemi hasur në:

Faleminderit (shumë): 7 herë

Flm (shum): 6 herë

Faleminderit plus emri: 14 herë

Flm shum plus emri: 2 herë

Thank you (very much): 3 herë

Thnx plus emri: 1 herë.

Fjala *faleminderit* si e plotë, është përdorur 21 herë.

Fjala *faleminderit* si shkurtesë flm, është përdorur 22 herë.

Fjala *faleminderit* e përdorur në gjuhën angleze, thank you, është përdorur tri herë.

Si shkurtesë thx, është përdorur 1 herë.

Këto raste dëshmuar për një situatë ku variacionet dialektore, fjalët e huazuara, zhargoni e shkurtesat, dominojnë dukshëm ndaj normës së shqipes standarde, duke ndikuar kështu edhe në gjuhën e folur edhe jashtë rrejturave sociale.

Me rastin e këtij punimi, unë dola në fshatin tim që të zhvilloj biseda me banorët. Më interesonte përdorimi i gjuhës nga ana e tyre e sidomos nga të moshuarit. Takova një plak rreth moshës 86-vjeçare , e ndala dhe fillova me një përshëndetje:

- Përshëndetje!

Nuk dha përgjigje.

- Si jeni?

Ai mbeti i shtangur, pasi që nuk e kuptoi variantin e përdorur nga ana ime, e ma ktheu:

- Shka po thu?

Pastaj u përpoqa që t'i nënshtrohem të folmes së tij dialektore, në mënyrë që të kuptohemi. E njëjta gjë ndodhi edhe me shumë të tjerë.

Tek adoleshentët vërehet një përdorim që i afrohet pakëz standardit, por ende është larg, por e keqja këtu është se ata përdorin shumë shkurtesa dhe fjalë të huaja, që unë personalisht kam bërë thirrje që të reduktohet në masë të madhe ky fenomen.

Nevojitet shumë punë që fillimisht të zhduken shkurtesat, përdorimi i fjalëve të huaja dhe mënjanimi i dialektizmave, që kështu të afrohet tek gjuha standarde, tek gjuha, e cila duhet të jetë e pranishme në çdo pjesë të shqipfolësve, për arsye se me të vërtetë kultura e një populli vërehet pikërisht në të folur.

Përfundime

Si përfundim i temës vërehet dhe kuptojmë se vullneti i shumicës dhe mënyra e qasjes

së tyre në rrjetet sociale tashmë përditshmëri e secilit, jo vetmë që e ka marrë hovin e ska të ndalur por edhe në një far mënyre e ka deformuar komplet kodin e mirësjelljes së njerëzimit. Tani nëse një mik nuk ta bën tag ose like në faqen e postimit tuaj, ai automatikisht nuk llogaritet më si një mik dhe ka raste kur për një gjë të tillë kaq të vogël edhe mund të hiqet nga lista e miqve. Pastaj dukuria tjetër gjatë hulumtimit të kësaj teme del në pah se sa më shumë përdorim të rrjeteve sociale aq më pak ka biseda në rrethin shoqëror, familjar dhe në përgjithësi. Vlenë të theksohet se ka shumë raste kur përmes rrjetit thërrasim miqtë e shokët që të dalim për ndonjë kafe dhe prapë se prapë flasim mbi rrjetet sociale dhe mbi të rejat që me mijëra postohen brenda minutes dhe që janë të pranishme në shoqëri, pra me një fjalë ka raste kur kafënë e pimë bashkë me mikun a mikeshën dhe shumë pak flasim në mes vete.

Nga kjo pamë se në rrjete sociale përdoret një gjuhë e veçantë, larg varietetit të standardizuar. Ajo tashmë mund të konsiderohet si varietet më vete me tiparet e saj që e dallojnë atë nga varietetet e tjera të shqipes.

Shumica e shfrytëzuesve të rrjeteve sociale përdorin fjalët dialektore ose krahinore, fjalët e huazuara, zhargonin e shkurtesat, duke mos lënë anash as zëvendësimin e kodit, si dukuri mjaftë e përhapur aty.

Nga njëra anë, kjo formë e përdorimit të gjuhës, duke i'u shmangur normave gjuhësore, mund të jetë me e thjeshtë e më e shpejtë, por në anën tjetër, pikërisht duke i'u shmangur këtyre normave në komunikime të ndryshme në rrjete sociale, ndikon edhe në gjuhën e përdorur jashtë tyre, duke bërë që standardi të përdoret secilën herë e më pak, madje edhe në domene formale, ku gjuha e standardizuar duhet përdorur patjetër.

Referencat

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipësisë sotme*, Tiranë, 1984

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1*, Tiranë, 2002

Çabej Eqrem, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976

<https://www.facebook.com/>

<http://www.fjalori.shkenca.org/>

<https://www.instagram.com/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Faqja_kryesore

<https://www.youtube.com/user/KlanKosovaOfficial>

Media, Revistë kërkimore, Universiteti i Prishtinës, Dega e Gazetarisë, Prishtinë, 2009

Hudson Richard. A., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2002

Munishi Shkumbin, *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhë standarde shqipe*, Prishtinë. 2013

Paçarizi Rrahman, *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, Prishtinë, 2011

Rugova Bardh, Sejdiu-Rugova Linditë, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2015

Sosyr Ferdinand de, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1977

Thomai Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006